

26.09 2017 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari individual Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Shtime, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2037-8/15 të dt.02.06.2016 për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtje të shqyrtimit gjyqësor, me dt.19.07.2016 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2037-8/15 të dt.02.06.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna Shtime, i lindur me dt. [REDACTED], në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me dt.02.10.2015 rreth ores 15:40 në vendin e quajtur "Livadhet e Papazit", në rajonin ekonimiko-pyJOR Nerodime-Jezerc, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyr të kundërligjshme për vete apo personit tjetër, kryersi i veprës penale është takuar duke prerë 28 copa dru të llojit ah, me sharrë motorike, me dimensione diameter 16-18 cm, me dimensione të gjata Bonita III meter, me vëllim të përgjithshëm prej 2.21 metër kub, dhe i ka bartur me vetur Pikap, me të cilin veprim ka dëmtuar Drejtorin për Zhvillim Ekonomik në Ferizaj në vler prej 338,13 €

Me të cilën kreu veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7, 17,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPPK-së.

GJYKON

Të akuzuarin [REDACTED] me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, sipas nenit 46, par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 Euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 338,13 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, këto në fat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2037-8/15 të dt.02.06.2016, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Shtime, për veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht, fletëparaqitjen e rojës së pyllit me vlersim dhe llogaritjen e dëmit të pyllit me nr.483/2015 e dt.26.10.2015, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 338,13 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerise së ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.510/2016 dt.19.07.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tete) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.

